



STATUTI

INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E
KOSOVËS

IRDK

Përmbajtja

STATUTI	1
I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET THEMELORE.....	5
NENI 1	5
Partia politike, emërtimi dhe simbolet.....	5
NENI 2	5
Dokumentet bazë Hierarkia e Akteve.....	5
II. ANËTARËSIMI NË IRDK, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË IRDK-SË.....	6
NENI 3	6
Anëtarësimi në IRDK.....	6
NENI 4	6
Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të IRDK-së.....	6
NENI 5	6
Statusi i anëtarit dhe mënyra e përjashtimit	6
III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I IRDK-SË.....	7
NENI 6	7
Njësitë themelore të organizimit të IRDK-së	7
NENI 7	7
Nëndega	7
NENI 8	7
Kuvendi i Nëndegës	7
NENI 9.....	8
Kryesia e Nëndegës	8
NENI 10.....	9
Dega	9
NENI 11	9
Kuvendi i Degës.....	9
NENI 12.....	10
Këshilli për marrëdhënie me publikun.....	10
NENI 13	10
Kryesia e Degës	10
NENI 14	11

Kryetari i degës	11
NENI 15	11
Nënkryetaret e degës.....	11
NENI 16	12
Sekretari organizativ i degës	12
NENI 17	12
Degët e IRDK-së në diasporë.....	12
NENI 18	12
Kuvendi Përgjithshëm i IRDK-së.....	12
NENI 19	13
Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit të Përgjithshëm.....	13
NENI 20	14
Sekretari i Kuvendit të Përgjithshëm	14
NENI 21	14
Kuvendi i Jashtëzakonshëm	14
NENI 22	15
Këshilli Drejtues i IRDK-së.....	15
NENI 23	15
Organizimi dhe Kompetencat e Këshillit Drejtues të IRDK-së	15
NENI 24	16
Këshilli Koordinues i IRDK-së	16
NENI 25	16
Organizimi dhe kompetencat e Këshillit koordinues të IRDK-së.....	16
NENI 26	17
Kryesia e IRDK-së	17
NENI 27	17
Kryetari i IRDK-së.....	17
NENI 28	18
Zgjedhja e kryetarit të IRDK-së.....	18
NENI 29	19
Nënkryetaret e IRDK-së	19
NENI 30	19
Sekretari i përgjithshëm i IRDK-së	19

NENI 31	19
Përgjegjësi i Financave	19
NENI 32	20
Zëdhënësi i IRDK-së	20
NENI 33	21
Komisioni statutar i IRDK-së	21
NENI 34	21
Forumi i Gruas i IRDK-së	21
NENI 35	22
Forumi Rinor i IRDK-së	22
NENI 36	22
Kryetari i Nderit	22
NENI 37	22
Sekretari organizativ	22
NENI 38	23
Dispozitat përfundimtare	23
NENI 39	23
Hyrja në fuqi e statutit të IRDK-së	23

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE PARIMET THEMELORE

NENI 1

Partia politike, emërtimi dhe simbolet

- 1.1. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës është parti politike e egjiptianeve të Kosovës dhe qytetarëve tjerë të cilët pranojnë programin dhe statutin e saj. Qëllimet dhe parimet e Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës janë përcaktuar në programin politik.
- 1.2. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës është parti e qendrës me orientim socialdemokrat. Veprimtaria e saj është e përqendruar në mirëqenien sociale, ekonomike, arsimore, kulturore të qytetareve të Kosovës dhe në veçanti promovimin e identitetit etnik, vlerave kulturore e historike dhe avancimin e pozitës së egjiptianeve të Kosovës.
- 1.3. Emri i partisë është: Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës me shkurtesën : IRDK.
- 1.4. Selia e partisë është në Pejë .
- 1.5. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës vepron në territorin e Kosovës dhe në diasporë në pajtim me dispozitat të shteteve përkatëse.
- 1.6. Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës ka simbolin që përbehet prej akronimit IRDK, hartën e Kosovës me gjashtë yje mbi akronim, vulën në të cilën shkruan: Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës. Vula e degës është e njëjtë me vulën e qendrës, por përmban edhe emrin e degës.

NENI 2

Dokumentet bazë Hierarkia e Akteve

Statusin e dokumentit bazë e kanë:

- 2.1. Dokumenti bazë i IRDK-së është Statuti.
- 2.2. Dokumente tjera të IRDK-së janë Rregulloret e punës së Kryesisë së IRDK-së dhe Këshillit Drejtues.

II. ANËTARËSIMI NË IRDK, TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E ANËTARËVE TË IRDK-SË

NENI 3

Anëtarësimi në IRDK

- 3.1. Anëtar i IRDK-së mund të bëhet çdo qytetar i Kosovës mbi moshën 18 vjeç, i cili pranon Programin dhe Statutin e IRDK-së.
- 3.2. Anëtarësimi bëhet individualisht, bazuar në deklarinimin e lirë përmes plotësimit dhe nënshkrimit të formularit për anëtarësim në IRDK.
- 3.3. Anëtarët e IRDK-së posedojnë librezën e partisë dhe mund të kontribuojnë financiarisht për anëtarësim në parti.

NENI 4

Të drejtat dhe detyrimet e anëtarit të IRDK-së

Anëtar i IRDK-së ka të drejtë dhe obligim:

- 1) të merr pjesë në përcaktimin dhe zbatimin e politikës partiake në format e parapara me këtë statut.
- 2) Të zgjedhë dhe të zgjidhet në organet e partisë.
- 3) Të zgjidhet në organet dhe format e organizimit të partisë.
- 4) Të kandidohët për zgjedhje në listat e partisë.
- 5) Të respektoj statutin, programin dhe vendimet e IRDK-së
- 6) Të veprojë aktivisht në IRDK duke marrë pjesë dhe duke ndihmuar realizimin e programit zgjedhor dhe aktivitetet tjera të IRDK-së.

NENI 5

Statusi i anëtarit dhe mënyra e përjashtimit

- 5.1. Anëtarësia në IRDK ndërpritet:
 - a) me largim vullnetar.
 - b) me përjashtim për shkak të veprimeve në kundërshtim me Programin, Statutin, qëndrimet dhe vendimet e IRDK-së.

- c) me anëtarësim në parti ose organizatë tjetër politike.
- 5.2. Vendimin për përjashtimin e anëtarit të IRDK-së e merre Këshilli Drejtues i partisë sipas propozimit të arsyetuar me shkrim të kryesisë së degës përkatëse.
- 5.3. Kundër vendimit për përjashtim mund të bëhet ankesë Komisionit Statutar brenda afatit prej 30 ditëve nga marrja e vendimit.
- 5.4. Ankesën për përjashtim nga IRDK e shqyrton Komisioni Statutar i IRDK-së

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I IRDK-SË

NENI 6

Njësitë themelore të organizimit të IRDK-së

- 6.1 . IRDK përbëhet nga organet e përgjithshme të partisë, degët dhe nëndegët.
- 6.2. Organet Qendrore të partisë janë:
- 6.3. Kuvendi i përgjithshëm i IRDK-së
- 6.3. Këshilli Drejtues i IRDK-së
- 6.4. Kryesia Qendrore e IRDK-së
- 6.5. Kryetari i IRDK-së

NENI 7

Nëndega

- 7.1 Nëndega është njësitë themelore e organizimit të IRDK-së
- 7.2 Nëndegët e IRDK-së formohen në nivel të lagjeve të qyteteve ose fshatrave
- 7.3 Të gjitha nëndegët e një komune e përbejnë degën e një komune
- 7.4 Organet udhëheqëse të nëndegës janë: Kuvendi dhe Kryesia e nëndegës

NENI 8

Kuvendi i Nëndegës

- 8.1 Kuvendi i Nëndegës mbledhet një herë në dy vjet dhe sipas nevojës thirren Kuvende të jashtëzakonshme.

- 8.2 Kuvendin e Nëndegës e përbejnë të gjithë anëtarët e IRDK-së nga territori i nëndegës.
- 8.3 Kompetenca e Kuvendit të nëndegës janë:
1. Zgjedh dhe shkarkon: Kryetarin, Nënkyetaret, Sekretarin organizativ dhe anëtarët e Kryesisë së nëndegës së IRDK-së.
 2. Zgjedh delegatët për Kuvendin zgjedhor të degës
 3. Miraton raportin e punës së Kryesisë së nëndegës dhe objektivat e punës së Kryesisë së nëndegës
- 8.4 Minimumi i numrit të delegatëve të nevojshëm për Kuvendin e nëndegës është më shumë se gjysma e anëtareve të IRDK-së nga territori i nëndegës.
- 8.5 Zgjedhja e strukturës udhëheqëse e nëndegës bëhet përmes votimit të listës së 5 deri 9 (pesë - nëntë) kandidateve. Fituesi i numrit më të madh të votave zgjedhet nënkryetar i nëndegës së IRDK-së, dhe pastaj në bazë të numrit më të madh të votave zgjedhet: sekretari organizativ dhe dy anëtarët e Kryesisë së nëndegës së IRDK-së.
- 8.6 Mënyra e kandidimit dhe e zgjedhjes së kryetarit të nëndegës përcaktohet nga Kryesia Qendrore e IRDK-së.

NENI 9

Kryesia e Nëndegës

- 9.1 Kryesia e nëndegës së IRDK-së është organ politik i nëndegës.
- 9.2 Kryesia e nëndegës së IRDK-së i ka 5 deri në 9 anëtarë.
- 9.3 Kryesia e nëndegës së IRDK-së:
1. Zbaton politiken e përcaktuar nga Kuvendi i nëndegës së IRDK-së dhe nga organet tjera udhëheqëse të Partisë
 2. Është përgjegjëse për organizimin e nëndegës, për organizimin e fushatave zgjedhore dhe grumbullimin e fondeve të caktuara për IRDK-në

- 9.4 Kryetari i nëndegës së IRDK-së e udhëheq nëndegën në aktivitete e nëndegës: thërret dhe kryeson mbledhjet e Kryesisë dhe Kuvendit të nëndegës, dhe e ka votën vendimtare gjatë marrjes së vendimeve në rast të barazimit të votave
- 9.5 Nënkryetari i nëndegës e zëvendëson kryetari kur ai mungon dhe e ndihmon kryetarin në realizimin e detyrave të tij.
- 9.6 Sekretari organizativ i nëndegës së IRDK-së është përgjegjës për administrimin e nëndegës, për mbajtjen e procesverbaleve, shpërndarjen e materialeve të Partisë të anëtarët dhe mbajtjen e kontakteve në mes të Kryesisë së nëndegës me anëtarët e IRDK-së.

NENI 10

Dega

- 10.1 Dega formohet në territorit e një komune dhe duhet të ketë së paku 3 nëndegë.
- 10.2 Organet udhëheqëse të degës janë: Kuvendi, Kryesia e degës dhe Kryetari

NENI 11

Kuvendi i Degës

- 11.1 Kompetenca e Kuvendit të degës janë:
1. Zgjedh dhe shkarkon: Kryetarin, Nënkryetaret, Sekretarin organizativ dhe anëtarët e Kryesisë së degës së IRDK-së.
 2. Zgjedh delegatët për Kuvendin Qendror të Partisë
 3. Miraton raportin e punës së Kryesisë së degës dhe objektivat e punës së Kryesisë së degës
- 11.2 Mbledhjet e rregullta zgjedhore të Kuvendit të degës mbahen një herë në dy vjet dhe sipas nevojës thirren Kuvende të jashtëzakonshme.
- 11.3 Delegatë të Kuvendit të degës janë delegatët e zgjedhur nga nëndegët prej të cilëve derivon Kryesia prej 9 anëtarëve.
- 11.4 Numrin e delegateve të degës e përcakton Kryesia e degës duke u bazuar në kriteret e caktuar paraprakisht nga Kryesia Qendrore e IRDK-së.

- 11.5 Mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të degës e thërret Kryesia e degës me propozimin e 1/3 të anëtareve, në rast të shkeljeve të rënda të statutit dhe programit të IRDK-së nga ana e udhëheqësve të degës. Vendimi për mbajtjen e Kuvendit të jashtëzakonshëm merret me 2/3 e votave të anëtareve të Kryesisë së degës
- 11.6 Zgjedhja e strukturës udhëheqëse e degës bëhet përmes votimit të listës së 5 deri 14 kandidateve. Fituesi i numrit më të madh të votave zgjedhet nënkryetar i nëndegës së Partisë, dhe pastaj në bazë të numrit më të madh të votave zgjedhet: sekretari organizativ dhe dy anëtarët e Kryesisë së nëndegës së IRDK-së.
- 11.7 Mënyra e kandidimit dhe e zgjedhjes së kryetarit të degës përcaktohet nga Kryesia Qendrore e IRDK-së.

NENI 12

Këshilli për marrëdhënie me publikun

- 12.1. Këshilli për marrëdhënie me publikun është organ i cili komunikon me anëtarësinë lidhur me politikën që duhet ndjekur organet ekzekutive të partisë për përfaqësimin e duhur të interesave të anëtarësisë.
- 12.2. Këshilli i rekomandon veprime Kryesisë së degës.
- 12.3. Këshilli komunikon publikisht me publikun në mënyrë të pavarur nga Kryesia e degës.

NENI 13

Kryesia e Degës

- 13.1. Kryesia e degës së IRDK-së është organ ekzekutiv dhe politik i degës
- 13.2. Kryesia e së IRDK-së ka 9 anëtarë: Kryetarin, dy nënkryetar, Sekretarin Organizativ dhe anëtarët tjerë të Kryesisë. Kryetaret e nëndegëve të cilët nuk janë zgjedhur në Kryesinë e degës së IRDK-së janë pjesë e Kryesisë së degës por pa të drejtë vote (ex officio)
- 13.3. Kryesia e degës së IRDK-së
1. Zbaton politiken e përcaktuar nga Kuvendi i degës së IRDK-së dhe nga organet tjera udhëheqëse të Partisë.
 2. Është përgjegjëse për organizimin e degës, për organizimin e fushatave zgjedhore në kuadër të komunës.

3. Me shumicë të thjeshtë votash miraton listën e kandidateve për: delegatë në Kuvendin Komunal, anëtarë të qeverisë komunale dhe anëtarë të komisioneve të Kuvendit Komunal
4. Zgjedh Përgjegjës Financiar të degës i cili duhet të jetë nga radhët e anëtareve të Kryesisë së degës
5. Formon Grupe punuese për detyra konkrete të lidhura me çështjen organizative të IRDK-së.
6. Miraton Rregulloren e punës së degës, në të cilën përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të Kryesisë, të cilat nuk janë të përshkruara në statut.

NENI 14 **Kryetari i degës**

Përgjegjësitë e Kryetarit të degës janë:

- 14.1. e udhëheqë degën
- 14.2. i thërret dhe i udhëheqë mbledhjet e Kryesisë së degës
- 14.3. i thërret dhe i udhëheqë mbledhjet e Kuvendit të degës
- 14.4. është përgjegjës për funksionimin e degës
- 14.5. është përgjegjës për zbatimin e statutit dhe programit të IRDK-së
- 14.6. propozon marrjen e vendimeve për funksionim të efektshëm të degës

NENI 15 **Nënkryetaret e degës**

Në mungesë të kryetarit të degës funksionin e tij e ushtron nënkryetari i parë i degës. Në mungesë të kryetarit dhe nënkryetarit të parë funksionin e kryetarit e ushtron nënkryetari i dytë

NENI 16

Sekretari organizativ i degës

Sekretari organizativ i degës është përgjegjës për:

16.1. Organizimin e punëve për funksionimin e degës

16.2. I raporton Kryesisë së degës për aktivitetet e përgjithshme në funksionimin e degës

16.3. Organizon punën në mes të Kryesisë së degës dhe kryesive të nëndegëve

16.4. I raporton Kryesisë së degës për aktivitetin e përgjithshëm të nëndegëve

NENI 17

Degët e IRDK-së në diasporë

17.1. Në pajtim me këtë statut dhe me ligjet në fuqi të shteteve përkatëse, Partia Egjiptiane organizon degë në diasporë.

17.2. Dega në diasporë formohet në territorin e një rajoni të caktuar gjeografik (qytet, kanton, land, shtet). Për territorin e veprimit të degës vendos bashkësia e degëve të IRDK-së në diasporë dhe Kryesia e IRDK-së. Degët në diasporë mbajnë lidhje hierarkike me Kryesinë e IRDK-së.

17.3. Në Kuvendin e degës marrin pjesë të gjithë anëtarët e partisë nga rajoni i përkufizuar i degës dhe minimumi i numrit të delegatëve për Kuvendin zgjedhor të degës duhet të jetë më shumë se gjysma e anëtareve të partisë nga territori i përcaktuar i degës.

17.4. Të gjitha degët të cilat veprojnë në një shtet përbejnë bashkësinë e degëve të partisë në atë shtet.

17.5 Kryetaret e degëve dhe 5 aktivistet e dalluar përbejnë Kryesinë e Bashkësisë së degëve.

NENI 18

Kuvendi Përgjithshëm i IRDK-së

18.1. Kuvendi i përgjithshëm i IRDK-së është organi më i lartë vendimmarrës

18.2. Kuvendi i Përgjithshëm i IRDK-së ka këto përgjegjësi:

1. Analizon punën e IRDK-së për periudhë në mes të dy kuvendeve dhe nxjerrë vendime, rekomandime, deklarata, rezoluta dhe përcakton orientimet kryesore.
2. Miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe programin e IRDK-së
3. Shqyrton dhe vlerëson punën e Kryesisë së partisë dhe Këshillit Drejtues të IRDK-së.
4. Zgjedhë dhe shkarkon Kryetarin e partisë dhe anëtarët e Këshillit Drejtues të IRDK-së.

18.3. Kuvendi zgjedhor, me votim të hapur e voton përbërjen e Këshillit Drejtues të IRDK-së.

NENI 19

Organizimi dhe funksionimi i Kuvendit të Përgjithshëm

19.1. Kuvendi zgjedhor i IRDK-së mbahet një herë në katër vjet.

19.2. Kuvendi i rregullt i partisë thirret nga Kryetari i IRDK-së.

19.3. Rendin e ditës për Kuvendin zgjedhor dhe të jashtëzakonshëm e përcakton Këshilli Drejtues i IRDK-së.

19.4. Kuvendin e hap Kryetari i IRDK-së.

19.5. Kuvendin e udhëheqë Kryesia e punës së Kuvendit e cila zgjedhet nga Kuvendi dhe ka mandat vetëm aq sa zgjasin punimet e Kuvendit.

19.6. Kuvendin e Përgjithshëm e përbëjnë të gjithë delegatët e zgjedhur në Kuvendet e degëve.

19.7. Numri i delegateve për Kuvendin e Përgjithshëm është 81

19.8. Këshilli Drejtues e përcakton numrin e delegateve nga secila degë e partisë duke u bazuar në rezultatin e zgjedhjeve të fundit parlamentare ose komunale.

19.9. Secila degë e cila vepron në diasporë e delegon nga 1 delegatë në Kuvendin e Përgjithshëm.

NENI 20

Sekretari i Kuvendit të Përgjithshëm

20.1. Sekretarin e Kuvendit të Përgjithshëm e zgjedh Këshilli Drejtues i IRDK-së.

20.2. Sekretarin e Kuvendit të Përgjithshëm është përgjegjës për mbarëvajtjen e punëve procedurale dhe teknike të Kuvendit.

20.3. Sekretarin e Kuvendit të Përgjithshëm është përgjegjës për arkivimin e dokumentacionit dhe procesverbaleve të mbajtura gjatë punës së Kuvendit.

20.4. Sekretarin e Kuvendit të Përgjithshëm e mbikëqyr punën e sekretarisë së Kuvendit puna e së cilës përfundon me përfundimin e punimeve të Kuvendit.

NENI 21

Kuvendi i Jashtëzakonshëm

21.1. Kuvendi i Jashtëzakonshëm i IRDK-së thirret:

1. Në rast të shkeljeve të rënda statusore ose programore nga ana e udhëheqësve të IRDK-së.
2. Në rast të shpalljeve të zgjedhjeve të jashtëzakonshme.

21.2. Kuvendin e Jashtëzakonshëm mund ta thërras Këshilli Drejtues:

- me kërkesën e 2/3 të anëtareve të vet;
- me kërkesë e 1/3 të delegatëve të Kuvendit të IRDK-së;
- me kërkesën e Kryesisë së partisë;
- me kërkesën e shumicës së degëve të IRDK-së

NENI 22

Këshilli Drejtues i IRDK-së

22.1. Këshilli Drejtues i IRDK-së është organi politik ekzekutivi IRDK-së

23.3. Këshilli Drejtues i Partisë Egjiptiane përbëhet nga 39 anëtarë, ku 35 prej tyre zgjidhen nga Kuvendi i përgjithshëm dhe 4 prej tyre ex-officio.

NENI 23

Organizimi dhe Kompetencat e Këshillit Drejtues të IRDK-së

23.1. Këshilli Drejtues i IRDK-së thirret dhe udhëhiqet nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues të IRDK-së.

23.2. Këshilli Drejtues i IRDK-së mund të thirret edhe propozimin e Kryetarit të partisë si dhe më kërkesën e 1/2 të anëtarëve të Këshillit Drejtues.

23.3. Këshilli Drejtues i Partisë mbledhet çdo tre muaj e sipas nevojës edhe më shpesh.

23.4. Këshilli Drejtues i partisë e miraton rregulloren e punës së vet.

23.5. Këshilli Drejtues i IRDK-së nxjerrë vendime me shumicën e thjeshtë të votave nga anëtarët e pranishëm, ndërsa për vendime të rëndësishme nevojiten 2/3 e votave të anëtarëve të pranishëm.

23.6. Kompetencat e Këshillit Drejtues janë:

1. Me shumicë votash emëron dhe shkarkon Kryesuesin e Këshillit Drejtues, anëtarët e Kryesisë, nënkryetarët, Sekretarin e Përgjithshëm së dhe përgjegjësin financiar të IRDK-së.
2. Përkujdesja për realizimin e detyrave të përcaktuara në Kuvendin e Përgjithshëm të IRDK-së.
3. Shqyrtimin dhe miratimin e listave të kandidatëve për deputet në Kuvendin e Kosovës. si dhe shqyrton dhe vendos për ndonjë koalicion të mundshëm me ndonjë parti tjetër para dhe pas zgjedhjeve nacionale dhe lokale.

4. Shqyrtimin dhe miratimin dhe vendosjen e kandidaturave për postet e larta qeveritare.
4. Shqyrtimin dhe miratimin e buxhetit vjetor të IRDK-së
5. Shqyrtimin dhe miratimin e raportit financiar vjetor të IRDK-së
7. Formon Komisione dhe Grupe pune në Funkcion të realizimit të detyrave të dhëna nga Kuvendi i Përgjithshëm i IRDK-së
8. Përcakton shumën që anëtari i partisë duhet të paguaj për anëtarësi.

NENI 24

Këshilli Koordinues i IRDK-së

24.1. Këshilli Koordinues i IRDK-së është organ i cili rekomandon veprime për Kryesinë e partisë të cilat kanë të bëjnë me përfaqësimin e interesave të anëtarësisë të partisë dhe realizimin e obligimeve statutare dhe programore të Kryesisë së partisë.

24.2. Këshilli Koordinues përbehet prej 7 anëtarëve të cilët janë personalitete nga radhët e komunitetit Egjiptian të Kosovës.

24.3. Njeri prej anëtarëve të Këshillit Koordinues është edhe Kryetari i IRDK-së

NENI 25

Organizimi dhe kompetencat e Këshillit koordinues të IRDK-së

25.1. Këshilli koordinues i IRDK-së thirret dhe udhëhiqet nga kryetari i Këshillit

25.2. Këshilli koordinues i IRDK-së mund të thirret edhe nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit

25.3. Mbledhja e parë konstituive e Këshillit thirret nga Kryetari i partisë apo nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit.

25.4. Kompetencat e Këshillit koordinues janë:

1. Me shumicë votash zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit.
2. Me shumicë votash miraton rekomandime për Kryesinë e IRDK-së.
3. Publikon dokumente strategjike dhe komunikata për publikun dhe mjetet e informimit .

NENI 26

Kryesia e IRDK-së

26.1. Kryesia e IRDK-së është organ mbilqyres-politik i qëndrimeve dhe vendimeve të aprovuara nga Kuvendi dhe Këshilli Drejtues i IRDK-së.

26.2. Kryesia e IRDK-së përbehet prej 15 anëtareve: Kryetari, 3 Nënkryetarët, Sekretari i Përgjithshëm, Kryetarët e degëve, Kryetari/ja i/e Forumit Rinor të IRDK-së nëse funksionon, Kryetarja e Forumit të Gruas nëse funksionon dhe anëtarët tjerë numri i të cilëve ndryshon në varësi të numrit të degëve.

26.3. Kryesia e IRDK-së miraton rregulloren e punës së vet në të cilën përshkruhen detyrat e secilit anëtar të Kryesisë, të cilat nuk janë përshkruar në këtë statut.

26.4. Kryesia e IRDK-së formon komisione dhe grupe punuese të cilat kanë për qëllim planifikimin strategjik, financiar dhe çështje tjera që ndërlidhen me përmbushjen e detyrimeve programore dhe statusore dhe funksionimin efikas të partisë.

26.5. Kryesia e IRDK-së harton buxhetin vjetor dhe më se largu në fillim të muajit dhjetor të çdo viti kalendarik i dorëzon draft buxhetin Këshillit Drejtues të IRDK-së për miratim.

26.6. Kryesia e IRDK-së është përgjegjëse për zbatimin programit dhe statutit të IRDK-së.

NENI 27

Kryetari i IRDK-së

27.1. Kryetari i IRDK-së është përgjegjës për:

1. Udhëheqjen e IRDK-së.
2. Zbatimin e programit dhe statutit të IRDK-së .
3. Përfaqësimin e IRDK-së.
4. Thirrjen e Kuvendit të rregullt të partisë.
5. Caktimin e delegacioneve në takimet zyrtare.

6. Thirrjen dhe kryesimin e mbledhjeve të Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të partisë.

27.2. I propozon Këshillit Drejtues së IRDK-së Përgjegjësin për Financa, shefin e shtabit zgjedhor, propozon dhe nënshkruan marrëveshje politike për koalicion, memorandum bashkëpunimi me parti, propozimet e kryetarit miratohen në Këshillin Drejtues të partisë.

Me qellim të respektimit të personaliteteve që kanë dhënë kontribut për Partinë kryetari mund të propozoi që personat e caktuar të shpalle kryetar nderi apo anëtar nderi të partisë.

Anëtarët e nderit nuk mund të ushtrojnë poste ekzekutive në parti të njëjtit kryejn vetëm funksione këshillëdhënëse për interesat e partisë.

27.3. Në rast të mungesës së tij, pamundësisë fizike ose vdekjes, kryetarin e zëvendëson, deri në Kuvendin e radhës, nënkryetari i parë i partisë.

27.4. Në rast të zgjedhjes në funksionin e deputetit të Parlamentit të Kosovës apo zëvendës ministër në Qeverinë e Kosovës, zgjedh në mes të funksionit të kryetarit të partisë dhe pozitive të shënuara më lartë.

NENI 28

Zgjedhja e kryetarit të IRDK-së

28.1. Votimi për kryetar behët me votim të fshehtë nëse Kuvendi nuk vendos ndryshe

28.2. Propozimet e kandidaturave për kryetar behët nga delegatët e Kuvendit

28.3. Në bazë të propozimeve të delegatëve formohet fletëvotimi për zgjedhjen e kryetarit dhe radhitja e emrave të kandidatëve bëhet në bazë të alfabetit.

28.4. Në rast të propozimit të më shumë se dy kandidatëve, dy kandidatët të cilët kanë më shumë vota do të votohen në raundin e dytë

28.5. Në raundin e dytë për kryetar zgjidhet kandidati i cili ka më shumë vota

28.6. Nëse në raundin e parë njëri nga kandidatët pas votimit ka marrë më shumë se 50% të votave të të gjithë delegatëve të Kuvendit, atëherë ky kandidat zgjidhet kryetar.

28.7. Në rast të propozimit të vetëm një kandidati për kryetar, Kuvendi mund të vendos që votimi për zgjedhje të kryetarit të behët me votim të hapur. Në këtë rast kryetari zgjidhet me shumicën e delegatëve të Kuvendit.

NENI 29

Nënkryetaret e IRDK-së

IRDK i ka tre zëvendëskryetar, të cilët e ndihmojnë kryetarin në realizimin e detyrave të tij. Në mungesë të zëvendëskryetarit të parë, detyrën e tij e ushtron zëvendëskryetari i dytë dhe në mungesë të zëvendëskryetarit të dytë, detyrën e tij e ushtron zëvendëskryetari i tretë i IRDK-së.

NENI 30

Sekretari i përgjithshëm i IRDK-së

30.1. Mbikëqyrë zbatimin e vendimeve dhe politikave të Kryesisë së IRDK-së

30.2. Raporton para Kryesisë dhe Këshillit Drejtues të IRDK-së për aktivitetet e përgjithshme të IRDK-së

30.3. Është përgjegjës për administratën e selisë qendrore të IRDK-së

30.4. Harton propozimet për organizimin dhe përparimin e IRDK-së

NENI 31

Përgjegjësi i Financave

31.1. Përgjegjësi i Financave zgjidhet nga Këshilli Drejtues me propozim të Kryetarit të IRDK-së

31.2. Raporton para këshillit drejtues dhe kryetarit në mënyre periodike lidhur me gjendjen financiare të buxhetit të IRDK-së. Partia Egjiptiane do ta ketë edhe një bashkë financiar i cili do të ketë të drejtë të kontrolloi gjirologarinë bankare në çdo kohë por nuk do të ketë të drejtë të tërheqjes, pagesave apo transferove të mjeteve financiare.

31.3 Mandati i tyre zgjat aq sa zgjat mandati i kryetarit

31.4. Është përgjegjës për menaxhimin e buxhetit të IRDK-së.

31.5. Përfaqëson punët financiare të IRDK-së në rastet e kontrollit qeveritar

31.6. Raporton para këshillit Drejtues në mënyrë periodike lidhur me gjendjen financiare të IRDK-së. Tërheqjet, transferet, dhe deponimet do të bëhen vetëm nga përgjegjëse financiar.

Shpenzimet me para në dorë nuk do të kalonin shumën prej 500 euro brenda 24 orëve ku çdo pagesë apo tërheqje duhet të nënshkruhet edhe nga njëri nga bashkëpërgjegjësit financiar.

Te gjitha transferet mbi 500 euro duhet të kryhen vetëm me transfere bankare.

Ne rast të shpërbërjes së partisë Kuvendi i Partisë është organi i cili merre vendim për shpërbërje, njëkohësisht merre vendim për shpërbërjen e fondeve të mjeteve të saja.

Fondet dhe mjetet e partisë i dhurohen ndonjëherë nga shoqatat humanitare që kanë selinë dhe vepron në Kosovë.

Kryetari i IRDK-së nuk ka të drejtë të përdorë, menaxhojë të tërheq apo të bëjë pagesa apo transferoj nga xhironlogaria bankare.

Kryetari do të ketë të drejtë në çdo kohë të monitoroi pasurinë e partisë duke pas të drejt të marrë pasqyrën bankare në çdo kohë.

Partia Egjiptiane realizon të ardhura nga kontributet vullnetare se dhe në çfarëdo forme tjetër e cila është në harmoni me rregulloren dhe normat juridike të IRDK-së.

Partia Egjiptiane paguan sipas kontratës së punës për anëtarët që kryejnë punë në organet e sajë.

NENI 32 **Zëdhënësi i IRDK-së**

32.1. Emërohet nga Kryesia e IRDK-së

32.2. Informon opinionin publik lidhur me aktivitetin politik të IRDK-në

32.3. Përgatit dhe thërret konferenca për shtypin

32.4. Pa të drejtë vote merr pjesë në mbledhjet e Kryesisë, Këshillit Drejtues dhe organet tjera udhëheqëse të IRDK-së

NENI 33

Komisioni statutar i IRDK-së

33.1. Komisioni statutar i IRDK-së përbëhet nga kryetari i partisë dhe tre anëtar te propozuar nga këshilli drejtues i partisë ku anëtarët preferohen të jenë jurist me profesion.

33.2. Është përgjegjës për hartimin, interpretimin dhe mbrojtjen e statutit të IRDK-së gjatë realizimin në praktikë

33.3. Shqyrton ankesat dhe kërkesat e anëtareve dhe organeve të IRDK-së të cilat janë të ndërlidhura me rregullat e përcaktuara me statutin e partisë

33.4. Vendimet e Komisionit statutar i vërteton dhe zbaton Këshilli Drejtues i IRDK-së

NENI 34

Forumi i Gruas i IRDK-së

34.1. Të gjitha gratë në IRDK-në mund të jenë të organizuara edhe në parti

34.2. Forumi i gruas ka strukturën e pavarur organizative

34.3. Anëtarët e forumit të gruas kujdesen për zbatimin e politikave të përcaktuara nga Kuvendi, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e IRDK-së

34.4. Forumi i gruas i zgjedh të gjitha organet e saj në Kuvendin e Përgjithshëm të forumit të gruas.

34.5. Kuvendi zgjedhor mbahet një herë në dy vjet, ndërsa Kuvendi i jashtëzakonshëm sipas nevojës

34.6. Organ udhëheqës të forumit janë Kryesia e Forumit të cilën e udhëheq kryetarja, dy nënkryetare, sekretarja dhe 3 anëtarët e Kryesisë

34.7. Kryetarja dhe nënkryetarja e parë e forumit janë anëtare të Këshillit Drejtues të IRDK-së, ndërsa kryetarja është anëtare e Kryesisë së IRDK-së.

NENI 35
Forumi Rinor i IRDK-së

35.1. Të gjithë të rinjtë në IRDK-në mund të jenë të organizuara edhe në forum te gruas

35.2. Anëtarë të forumit te gruas janë personat e moshës deri në 30 vjeç

35.3. Forumi i gruas ka strukturën e pavarur organizative

35.4. Anëtarët e forumit te gruas kujdesen për zbatimin e politikave të përcaktuara nga Kuvendi, Këshilli Drejtues dhe Kryesia e IRDK-së.

35.5. Forumi i gruas i zgjedh të gjitha organet e saj në Kuvendin e Përgjithshëm të forumit te gruas.

35.6. Kuvendi zgjedhor i forumit bte gruas mbahet një herë në dy vjet, ndërsa Kuvendi i jashtëzakonshëm sipas nevojës

35.7. Organ udhëheqës i forumit te gruas është Kryesia e forumit të cilën e udhëheq kryetari/ja, dy nënkryetaret, sekretari/ja dhe 3 anëtarët e Kryesisë

35.8. Kryetari/ja dhe nënkryetari/ja i/e parë te forumit janë anëtarë të Këshillit Drejtues të forumit, ndërsa kryetari/ja është anëtar i Kryesisë së IRDK-së.

NENI 36
Kryetari i Nderit

36.1. Kryetari i Nderit të IRDK-së propozohet nga Kryetari i partisë dhe votohet nga Kuvendi i Përgjithshëm

NENI 37
Sekretari organizativ

37.1. Është përgjegjës për organizimin e strukturave të partisë dhe ngjarjeve të cilat organizohen nga partia.

37.2. Sekretari organizativ zgjidhet nga Këshilli Drejtues.

NENI 38
Dispozitat përfundimtare

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen sipas procedurës për nxjerrjen e tij. Propozimin për ndryshimin e statutit mund ta japë Kuvendi i partisë, këshilli drejtues dh kryetari.

Interpretimin autentik të statutit dhe marrëveshjeve të arritura e bënë Këshilli Drejtues i partisë.

Shpjegimet për ndryshimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij statuti e jep komisioni statutar.

NENI 39
Hyrja në fuqi e statutit të IRDK-së

Ky statut hynë në fuqi nga dita e aprovimit të të gjitha dispozitave nga ana e Kuvendit të përgjithshëm të IRDK-së.

Çdo rregullore apo vendim dhe akte tjetër individual duhet të përmbahet këtij statuti.

Kryetar i Partisë
Elbert Krasniqi